



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVË-SKUPSTINA OPŠTINE MALISHEVO



PRANUAR MË:
PRIMI I ENO:
Nr. No. Dh. 01/1503

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS

Zyra e Personelit

Nr.01/_____

Më: 15.11.2023

Në bazë të nenit 95, par. 1 dhe par. 2, nenit 96 dhe 97 të Ligjit për Zyratë Publik Nr. 08/L-197, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.21, i datës 18 Shtatorë 2023, Prishtinë, dhe Ligjit të Punës, 03/L-212, nenit 8, dhe Rregullores (QRK) Nr. 05/2022 për Procedurat Konkurruese dhe Pranimi për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës neni 6 dhe neni 7, Komuna e Malishevës shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Vozitës - për nevojat e Administratës së Komunës
Institucioni: Komuna e Malishevës
Departamenti/ Drejtoria: Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik
Numri i pozitave: (1) Një
Titulli i mbikëqyrësit: Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme
Grada/Koeficienti: GJ50 – 3.8
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publik:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje (Certifikatën nën hetim);
- Të mos ketë në fuqi ndonjë masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik.

Detyrat dhe përgjegjësitë për Vozitësit

- Drejton automjetin sipas kërkesës të mbikëqyrësit, si dhe kujdeset për automjetin me të cilin është i ngarkuar;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e tij, pastrimin, evidentimin e prishjeve etj;
- Mirëmban edhe automjetet e tjera sipas orarit të punës përmes mbikëqyrësit të tij;
- Përgjigjet për automjetin dhe pajimet e automjetit;
- Në fletudhëtim regjistron numrin e kilometrave të kaluara në udhëtim, dhe shënimet tjera të cilat kërkohen;
- Paraqet mbikëqyrësit të tij, çdo defekt dhe dëme të shkaktuar në automjet, dhe bën arsyetimin e shpenzimeve të derivateve dhe kilometrazhit të kaluar;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës të mbikëqyrësit dhe drejtorit të drejtorisë;
- Për punën e tij i përgjigjet mbikëqyrësit drejtorit të drejtorisë DAP.

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve:

- Njohja e duhur profesionale;
- Të ketë diplomën e shkollës së mesme;
- Të ketë të kryer kategorinë "B"- të patentë shoferit;

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit i plotësuar;
- Dokumenti personal (Letërnjoftimi apo Pasaporta), fotokopje;
- Diploma e shkollës se mesme;
- Kopjet e patentë shoferit;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime (Originali);
- Certifikata e Mjekut (pas përzgjedhjes nga Komisioni).

Dokumentet duhet të jenë në Kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen në rastin e intervistimit.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata të cilat do të jenë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike, aplikacionet dorëzohen nga data 16.11.2023 deri më 30.11.2023, ora (16:00), në Zyrën për pritjen e palëve KK- Malishevë.

Paraqitja e kërkesave:

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë në këtë vend të punës janë të obliguar që t'i marrin dhe dorëzojnë aplikacionet në Zyrën për pritjen e palëve KK- Malishevë, si dhe mund të shkarkohen nga ueb-faqja zyrtare e Komunës së Malishevës, dhe të plotësuara dorëzohen në zyrën e pranimit.

Konkursi është i shpallur në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> , si dhe ne web faqen e Komunës së Malishevës dhe tabelën e shpalljeve në Komunën e Malishevës.

-Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

-Për shkak të numrit të madh të kërkesave, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Gani Bahtjaraj, jur.dipl.

